



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 19 qershor 2022, në mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII,

E mbajtur për nderë të 19 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Podujevës.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës së në vijim; (*Demokrat Hodolli, Adnan Zymeri, Arjant Topanica, Naim Çunaku, Ekrem Rrahmani, Fahri Hasani, Fitim Muçolli, Artrit Mulliqi, Kasib Bashota, Sebastina Vokrri, Drita Pajaziti, Qëndresë Hajrizi, Ragip Fetahu, Xhevdet Maloku, Ardi Hasani, Bahri Blakçori, Bashkim Sylja, Mimoza Abdullahu, Mrika Thaçi*), ndërsa munguan (*Valon Demolli, Arnisa Sylejmani, Arjeta Abazi, Edona Shabani, Donjetë Sheqiri, Ilir Koprani, Qendrim Softolli, Tringa Sfishta, Florent Hasani, Adelinë Stublla, Haki Rudari, Endritë Murati, Burim Hasani, Arbnor Fazliu, Gazmend Islami*) - Lista e nënshkrimeve.

Në mbledhje të pranishëm ishin z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Podujevës, (*Saranda Stublla-DPKGJ, Vigan Salihu-DPZHE, Driton Velu-DSHMS, Pajtim Balaj-DKRS, Bensik Mulliqi-DI, Bahri Selimi-DSHPMSH, Leutrim Krasniqi-DPUMM*).

Gjithashtu, me ftesë të Kryetarit të Komunës, në mbledhje të pranishëm ishin edhe familjarë të Heronjve dhe Dëshmorëve të Kosovës, përfaqësues të Organizatave të dala nga Lufta (*z.Kadri Balaj, z.Xhemshit Gashi, z.Fahri Balaj, z.Fadil Mulliqi, z.Naim Zhitia*).

Në mbledhje gjithashtu të pranishëm ishin e dhe z.Naim Haziri, Gjeneral në Forcën e Sigurisë së Kosovës, z.Nijazi Jashari-Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës z.Agim Velu, z.Vendenis Lahu, z.Fitim Haziri.

Në mbledhje pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues nga Qyteti Velbert dhe CDU të Republikës Federale të Gjermanisë, z.Bughardt Fuling, znj.Silvia Cuper, znj.Claudia Schwarz, z.Rahman Islami, media të shkruara dhe elektronike dhe një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve të Komunës.

Mbledhja u hap me Intonimin e Himnit të Republikës së Kosovës dhe Himnit të Republikës së Shqipërisë-Himni Kombëtar

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar mirëseardhje në këtë mbledhje Solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës e cila organizohet me rastin e 23 vjetorit të Çlirimit të territorit të Komunës së Podujevës, konkretisht e 19 Qershorit – Dita e Çlirimit të Podujevës.

Në nderim të të gjithë Dëshmorëve dhe të rënëve të Kombit për liri, ju ftoj për 1 minutë heshtje;

Mbahet 1 minutë heshtje

- **Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

z.Hilmi Hoxha, vazhdoi me fjalë rasti duke theksuar, kjo ditë e shumëpritur u arrit pas përpjekjeve shekullore të shumë brezave. 19 Qershori shënon përfundimisht largimin e pushtuesit serb dhe aparatit të tij pushtues nga Treva jonë.

Shqiptarët gjithmonë gjatë historisë u angazhuan për liri, kështu ndodhi gjatë luftës së II-të botërore, fundi i saj nuk e solli lirinë, fillojë dhuna serbo-jugosllave, u pushkatuan dhe u vranë shumë intelektual dhe qytetar të Komunës tonë dhe Kosovës dhe një ndër intelektualët që u pushkatua në atë kohë ishte edhe Jahjah Fusha, përkundër të gjithave, të parët tan nuk u nënshtuan, Heroi i Kombit Shaban Shala, nderi i Kombit Adem Demaçi, atdhetari Xheladin Rekaliu me bashkëveprimtarët mbajtën frymën Kombëtare gjallë duke zhvilluar veprimtari për çlirimin e Kosovës.

Pastaj, vie epoka e viti 1981 ku me armë në dorë dhe në demonstratat që organizoheshin në atë kohë në Komunën tonë dhe në gjitha qytetet e Kosovës, ranë dëshmorë me pushkë në dorë Ali Ajeti, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Hasan Ramadani, Ylfete Humolli, Fadil Talla, Besim dhe Skender Latifi dhe shumë e shumë të tjerë.

Treva e Llapit dhe e Gollakut është Kështjellë e rezistencës Shqiptare, dhe kjo dëshmohet më së miri edhe me luftën e UÇK-së ku heronjtë Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu, Ilir Konusheci dhe te gjithë dëshmorët dhe luftëtarët trima përfundimisht larguan forcat Serbe nga toka jonë.

Falënderim i veçantë i takon miqve tanë të përhershëm, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe NATO-së, ku populli ynë do të jetë përgjithmonë falënderues ndaj tyre.

Ju jemi mirënjohës përjetë Dëshmorëve, invalidëve të luftës, luftëtarëve dhe veprimtarëve politik të të gjitha periudhave që kontribuan për çlirimin e trevës sonë dhe Kosovës.

Tani ftoj Kryetarin e Komunës z.Shpejtim Bulliqin, për një fjalë rasti.

- **Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës**

z.Shpejtim Bulliqi, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, e nderuara Nënkryetare e Komunës, Marigona Lahu, të nderuar deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të nderuar drejtor të Drejtorive të Komunës, anëtar/e të Kuvendit të Komunës, i nderuar Gjeneral i Forcës së sigurisë së Kosovës z.Naim Haziri, Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë z.Njazi Jashari, të respektuar përfaqësues të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, Familje të Dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës,

Të nderuar mysafirë nga Komuna e Velberit, përfaqësues të institucioneve, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave dhe ju të pranishëm të tjerë, i respektuari z.Bughardt Fuling mirë se keni ardhë në Podujevë.

Jemi mbledhur sot këtu, për të shënuar një datë që kuptimëson angazhimin dhe sakrificën e shumë gjeneratave, që nga periudhat e hershme historike deri tek lufta e UÇK-së, e cila me ndihmën e miqve perëndimor, solli lirinë dhe shtetësinë e Kosovës.

19 Qershori shënon datën e fundit, nga kalendari i ditëve të çlirimit nëpër komunat e Kosovës. Podujeva si një ndër komunat kufitare, ishte e fundit që u çlirua. Por jo vetëm për këtë arsye, Podujeva është komuna që ka histori të gjatë të revoltave kombëtare. Çdo periudhë historike, njeh figura Kombëtare të cilët me qëndresën e tyre te çeliktë, ndihmuan dhe ruajtjen vazhdimësinë e idesë kombëtare për çlirim.

Podujeva frymon kombëtarisht në çdo periudhë, Llapi dhe Gollaku ishin në ballë të rezistencës me bacën Adem Demaçi dhe mësuesin Shaban Shala, ishin në ballë të rezistencës me Xheladin Rekaliun në demonstratat për flamur të vitit 1968, ishin në ballë të demonstrative të vitit 1981 dhe vitit 1989 me Aliun, Afrimin e Fahriun, ishin në ballë të organizimit të jetës paralele me presidentin Rugova, ishin në ballë të luftës së UCK-së, me Zahirin, Hakifin, Bahriun, Ilirin, Agronin, me qindra Dëshmorë e mijëra ushtarë të UÇK-së.

Duke qenë vatër e pashuar e rezistencës, Podujeva pësoi shumë nga pushtuesi fashist serb. Përgjatë brezash popullsia shqiptare ishte e diskriminuar dhe e persekutuar. Të rinjtë tanë burgoseshin dhe vriteshin. Në luftë dogjën shtëpitë tona, vranë gra, fëmijë dhe pleq. Çmimi që paguam për liri, ishte i lartë.

Kur kujtojmë ditët e vështira, vuajtjet dhe sakrificat, duhet të jemi koshient dhe të përgjegjshëm përballë detyrave që i kemi, jo vetëm nga të gjallët që na votuan, por sidomos ndaj përgjegjësisë që na buron nga të rënë. Në çështje të interesit të përbashkët, duhet të jemi një, siç ishim dikur sepse siç fituam dikur të bashkuar edhe sot jemi të pathyeshëm.

Ishim shumë keq. Por kurrë s'kemi qenë më mirë. Shqiptarët sot përfaqësohen me tre kryeministra në tri shtete të Ballkanit, por ende ka shumë punë për të bërë. Faktorizimi i shqiptarëve në Ballkan, përtej romantizmit është domosdoshmëri për sigurinë dhe përparimin e gjithmbarshëm Kombëtar.

Liria përveç çmimit ka edhe obligimin e madh, shansin e kemi që të gjithë bashkërisht të përkushtohemi për zhvillim të gjithmbarshëm, për të siguruar të ardhme më të mirë të brezave të ri.

Për fund, të gjithë qytetarëve ju uroj nga zemra ditën e çlirimit të Komunës së Podujevës, urime dhe me fat.

Kryesuesi i Kuvendit, duke falënderuar Kryetarin e Komunës për këtë fjalë rasti, ftoj z.Rahman Islamin, përfaqësues nga qyteti Velbert i Gjermanisë që ta merr fjalën dhe ta prezantoj përfaqësuesin nga qyteti Velbert i Gjermanisë.

z.Rahman Islami, duke përshëndetur të pranishmit, theksoi, në emër të Kryetarit të Qytetit Velbert që është e binjakëzuar me Komunën e Podujevës kemi ardhur këtu me një delegacion të cilin po e prezantoj, është kryetari i CDU-së në Velbert z.Bughardt Fulung, menaxherja ose drejtoresha e CDU-së për Velbert apo në zyrën e Deputetit Peter Bayer, znj.Claudia Schwarz si dhe znj.Silvia Cuper e shoqja e z.Bughardt Fulung. Kam nderin të jem prezent këtu para Juve dhe t'ju premtoj se ashtu siç kam punuar deri më tani për binjakëzimin e Qytetit Velbert dhe Komunës së Podujevës dhe ndihmave për qytetin e Podujevës nga paslufta, edhe tani e tutje do të vazhdoj të jem krah i juaji edhe në të ardhmen në mënyrë që ta forcojmë dhe ta zhvillojmë ekonominë e Podujevës.

Podujeva ka nevojë për neve ashtu siç ka nevojë për juve dhe qytetarët Llapjan kanë nevojë për bashkim, për përkrahje dhe për sukses të përbashkët sepse pa qenë të bashkuar nuk mund të shkojmë përpara, ndërsa Partitë politike janë në rend të dytë kurse qytetarët janë në rend të parë, dhe ne si Kuvend i Velbertit dhe unë si i vetmi Shqiptar që përfaqësoj Komunën në parlamentin e Nerve që do të jem zëri juaj dhe do të jem ndihma për ju dhe do të angazhohemi që sa më shpejt Komuna e Podujevës të ketë një zhvillim ekonomik në mënyrë që ashtu siç janë bashkuar sporti, rinia dhe Komunitat të jetë e bashkuar edhe ekonomia, andaj edhe ju premtoj se do të jem krah juaj, dhe atëherë e prezantoj edhe kryetarin e CDU-së në Qytetin Velbert.

z.Bughardt Fulung, përfaqësues nga Komuna / Qyteti Velbert dhe Kryetar i CDU-së për këtë Komunë, duke përshëndetur të pranishmit, ndër të tjera theksoi, është një ditë e mirë për Juve, jam shumë krenar dhe shumë i gëzuar dhe shumë i lumtur që jam para Juve si kryetar i CDU-së në

rajonin e Velbert. Më lejoni t'ju përcjellë edhe përshëndetjet e Kryetarit të Komunës të Velbert z.Dirk Lukrafka dhe të Kuvendit të Velbert.

Lidhja mes Qytetit Velbert dhe Komunës së Podujevës është një kohë shumë të gjatë dhe është duke u zhvilluar që një kohë shumë të gjatë. Në vitin 1999 z.Rahman Islami ka qenë në Velbert dhe ka kërkuar nga Kuvendi i Velbert ndihmë dhe përkrahje për Qytetin e Podujevës, dhe në atë kohë ish Kryetari i atëhershëm i Velbertit dhe ish drejtues i një kompanie të shpëdicionit dhe transportit, menjëherë ka pranuar kur ajo kohë ka qenë 1 javë pas luftës së vitit 1999 dhe kemi sjellë ndihma prej 23 ton në Podujevë, andaj prej asaj kohe ekziston kjo lidhje mes Qytetit Velbert dhe Podujevës, dhe ka vazhduar edhe viteve të ardhshme duke u zhvilluar çdo herë e më shumë bashkëpunimi.

Vizita ime e parë në Podujevë ka qenë në vitin 2013 dhe pastaj në vitet 2016, 2018 dhe 2019 dhe mund t'ju them se Podujeva shumë ka ndryshuar në mënyrë pozitive. Ka qenë edhe një delegacion i Podujevës tek ne në Velbert ku në vitin 2015 ka qenë delegacioni i Podujevës në krye me ish Kryetarin e Komunës z.Agim Veliu dhe ka pas mundësi t'i vizitoj drejtoritë komunale si dhe deponinë e qytetit. Pastaj në vitin 2016 ka qenë edhe një delegacion i Podujevës në Velbert dhe këtu ka filluar të forcohet bashkëpunimi mes Kryetarit të Velbert z.Dirk Lukrafka dhe Kryetarit të Podujevës z.Agim Veliu, dhe pika apo kulmi më i lartë i bashkëpunimit mes Qytetit Velbert dhe Komunës së Podujevës ka qenë filluar në fund të muajit prill 2019 ku Kuvendi i Velbert ka marrë vendim që partneriteti ose binjakëzimi me Qytetin e Podujevës të realizohet ashtu sikurse edhe Kuvendi i Juaj i Komunës së Podujevës që ka marrë një vendim të tillë e që ka qenë konsekuencë e logjikshme që Kryetari i Velebert z.Dirk Lukrafka të vije në Podujevë dhe Certifikatën e Binjakëzimit ta nënshkruaj me Kryetarin e Komunës që ishte në atë kohë z.Agim Veliu.

Pra nga vitit 2019 ekziston edhe bukfalisht partneriteti apo binjakëzimi i dy qyteteve Velbert - Podujevë, e që neve në Velbert me shumë krenari e mbajmë këtë dhe kështu kanë qenë shumë plane tona të realizohen, shembull, infermieret/ët të vizitonin Spitalin e Qytetit Velbert për dy javë dhe të trajnohen me praktikat tona, mirëpo u shfaq Corona virus, por tani në këtë vizitë që jemi, kemi biseduar që atë plan që e kemi pasur ta realizojmë tani.

Një guri mes Velbert dhe Podujevës ka qenë në muajin janar të këtij viti që jemi, si Kryetar i CDU në Velbert ka nënshkruar me Kryetarin e LDK-së në Podujevë z.Agim Veliu një miqësi ose partneritet mes këtyre dy subjekteve dhe këtë partneritet ose miqësi CDU e ka votuar me unanimitet. Në shikimin tim është një punë që mund të zhvillohet edhe më shumë në mes dy Qyteteve.

Podujeva ka ndryshuar shumë shumë prej kur kam qenë unë në vitin 2013 deri më sot dhe dëshiroj t'i cilësoj vetëm disa projekte që i kam parë si një njeri që vije nga jashtë, një objekt komunal shumë i mirë, bulevardi i qytetit, parku dhe spitali, e të cilat në vitin 2013 nuk kanë qenë.

Realizimin e miqësisë ose partneritetit mes Velbert dhe Podujevës nuk do të mund ta bënim pa Rrahman Islamin, Peter Bayer dhe Agim Velin.

Për të ardhmen jam i lumtur që do të vazhdoj punën me Kryetarin e Komunës z.Shpejtim Bulliqi dhe dëshiroj nga zemra që t'i realizojmë dhe t'i qojmë përpara punët me Kryetarin e ri të Podujevës.

Edhe një gjë dëshiroj ta cekë dhe ka të bëjë me futbollin, FC Llapi, U17 kanë qenë në Velbert dhe atë me autobus nga Kosova, kanë dal nga autobusi, kanë marrë këpucët futbollit dhe kanë hyrë në fushë dhe i kanë fituar të gjitha lojë, dhe për këtë ju duhet të jeni shumë krenar.

Për fund Ju falënderoj shumë për këtë pritje dhe Ju dëshiroj nga zemra që të jeni më të suksesshëm me Kryetarin e Komunës, për çka besoj shumë se Podujeva është në rrugën e duhur dhe të mirë dhe ajo që është më e mira është se ne do t'ju përkrahim dhe do të zhvillojmë sepse mundemi të punojmë dhe të bëjmë shumë për çka po ashtu jam i gëzueshëm. Faleminderit.

(Ky diskutimi është nxjerrë nga përkthimi simultant i Rrahman Islamit)

Kryesuesi i Kuvendit, edhe njëherë falënderoj Kryetarin e CDU-së në rajonin e Velbert dhe njëkohësisht përfaqësues i qytetit Velbert për angazhimet dhe kontributin e dhënë për Komunën e Podujevës dhe projektet e realizuara, me theks e falënderoj që ka gjetë kohë për të na vizituar mu në një ditë shumë të rëndësishme për qytetin dhe shtetin tonë që është 19 Qershori - Dita e Çlirimit të Podujevës. Shumë faleminderit zotëri Fuling.

Tani fjalën e kalojmë sipas agjendës.

z.Fahri Balaj, në emër të Shoqatave të dala nga Lufta, duke përshëndetur të pranishmit, theksoi, viti kalendarik në Kosovë është i shoqëruar me përplot data të rëndësishme në të cilat kujtojmë Dëshmorët dhe ngjarjet të cilat janë të mëdha sepse secila nga to kishte pikënisje dhe synim për të arritur atë që shënojmë sot Ditën e Çlirimit.

Dita e Çlirimit shënon rezultatin e aspiratave të brezave të Popullit Shqiptar të cilat i gjejmë të gdhendura në historinë e lavdishme të Heronjve tanë. Të gjitha këto përpjekje u bënë frymëzim për djemtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët me armët e tyre e ndonjëherë me trupat e tyre dhe vullnetin e hekurt binden Botën për padrejtësitë historike dhe kauzën tonë të drejtë.

Në të kaluarën pati përparime por edhe u bënë gabime, e mira e përbashkët shpeshherë nuk ishte prioritet, shpresojmë të kemi mësuar nga e kaluara dhe e ardhmja të jetë ndryshe, të jetë siç e kanë ëndërruar Dëshmorët.

Juve që nuk patët fatin dhe as moshën të ishit ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, çfarë mund t'ju themi, nuk ka ndjenjë më të lumtur se sa ndjenja e triumfatorit e sidomos ndaj armikut të cilin e kishim ne Shqiptarët, andaj punoni e veproni ndershëm sepse kështu jetësoni amanetin e Dëshmorëve.

Falënderim i veçantë për delegacionin nga Gjermania që ardhja e tyre koïncidon me ditën më të rëndësishme të Komunës tonë, pra faleminderit shumë.

Po ashtu dëshiroj të falënderoj atë që i ka shkuar ndërmend që në këtë seancë solemne ta ftoj Gjeneralin e FSK-së z.Naim Haziri gjegjësisht komandant Dilaverin.

Në emër të kategorive të dala nga Lufta, të gjithë juve Urime Dita e Çlirimit dhe lavdi e përjetshme për Dëshmorët e ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, falënderoj parafolësin z.Fahri Balaj, dhe me këtë edhe njëherë të gjithë Juve dhe gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës ju uroj 19 Qershorin Ditën e Çlirimit të Podujevës, pritshum edhe shumë Ditë të Çlirimit me suksese edhe më të mëdha.

Ju faleminderit për pjesëmarrje

Mbledhja përfundoi në ora 10:45

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.prot.01-060/04-0050023/22

Podujevë,

19 qershor 2022

Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha